



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05 - 68
Podujevë,
09.02.2021

Në mbështetje të nenit 17 pika s të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenit 19 pika s të Statutit të Komunës dhe nenit 14 paragrafi 2 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/111 – 400, Drejtoria e Arsimit, publikon :

KONKURS

për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme për vitin akademik / shkollor 2020 - 2021

Kriteret e përgjithshme

Përfitues të bursave mund të jenë :

- Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa
- Të mos jetë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër ose të jenë të punësuar
- Të mos jetë përsëritës i vitit akademik
- Të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomike – sociale të familjes
- Studentët që janë të regjistruar për herë të parë në fakultete, duhet të kenë dëshminë e suksesit të shkollës së mesme

Kriteret e veçanta

Studentët të cilët kanë notë mesatare :

- mbi 9.00 vlerësohen me 30 pikë
 - mbi 8.00 vlerësohen me 20 pikë
 - mbi 7.00 vlerësohen me 15 pikë
 - mbi 6.00 vlerësohen me 10 pikë
-
- Studentët dhe nxënësit në gjendje të vështirë ekonomike – shfrytëzues të asistencës sociale vlerësohen me 20 pikë
 - Studentët që studiojnë së bashku me një anëtar tjetër nga e njëjta familje vlerësohen me 10 pikë
 - Studentët dhe nxënësit që nuk i kanë prindërit në jetë vlerësohen me 10 pikë – nëna kryefamiljare (të dëshmohet me dokument adekuat).
 - Studentët dhe nxënësit me nevoja të veçanta vlerësohen me 10 pikë

Dokumentet e nevojshme për aplikim :


- Vërtetimin se studenti ka të regjistruar vitin akademik 2020 -2021
- Certifikata e notave - forma origjinale për studentë, ndërsa dëftesa për nxënës
- Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm
- Kopja e letërnjoftimit
- Vërtetim për shfrytëzimin e ndihmës sociale të lëshuar nga Qendra për punë sociale në Podujevë (kjo vlen për shfrytëzuesit që aktualisht marrin ndihmë sociale).

Vini re

Dokumentet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë në objektin e Komunës – rr. “ Nuhi Gashi “ , në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve të objektit të Komunës, në mediat e shkruara dhe në ueb-faqen e Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (09/02/2021 - 23/02/2021).

Lartësia e bursës do të caktohet varësisht nga buxheti i Drejtorisë për Arsim dhe nga numri i atyre që i plotësojnë kushtet për përfitim të bursës.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.



**Drejtori
Avni Fetahu**